



Bazuar në nenin 62 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008 e datës 04 Qershor 2008), neni 78.6 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 60/01-12895/20, Rregullores për Transport Rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut 01 Nr. 07 -104/02-13623/25 të datës 30.06. 2025, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, bën këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

PËR VAZHDIMIN DHE NDARJEN E VIJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK TË UDHËTARËVE NË KOMUNIKACIONIN LINJOR DHE LËSHUARJEN E LEJEVE TË PUNËS PËR VITIN

2026

Me këtë shpallje publike, njoftohen të gjithë qytetarët e interesuar që merren me transportin publik të udhëtarëve me autobus, kombi - bus dhe automjete me 4+1 ulëse, se mund të aplikojnë për marrjen e lejes së punës për vitin 2026 dhe atë:

1. Për linja me autobusë, (kombi-bus në ato vija ku nuk mund të operoj autobusi), mund të aplikojnë në:

Linjat:

- | | |
|--------------------------------|---------------------------------|
| 1. Kaçanik - Kovaçec | 12. Kaçanik - Kaçanik i Vjetër |
| 2. Kaçanik - Biçec | 13. Kaçanik - Begracë |
| 3. Kaçanik - Nikaj | 14. Kaçanik - Stagovë |
| 4. Kaçanik - Rekë | 15. Kaçanik - Duraj - Gabrricë |
| 5. Kaçanik - Imisht (Dubravë) | 16. Kaçanik - Semajë |
| 6. Kaçanik - Soponicë | 17. Kaçanik - Kotlinë |
| 7. Kaçanik - Sepetin (Dubravë) | 18. Kaçanik - Ivajë |
| 8. Kaçanik - Strazhë | 19. Kaçanik - Gajre |
| 9. Kaçanik - Gllaboçicë | 20. Kaçanik - Bajnicë |
| 10. Kaçanik - Doganaj | 21. Kaçanik - Runjevë |
| 11. Kaçanik - Elezaj | 22. Kaçanik - Gërllicë e Epërme |

2. Kushtet për pajisje me Licencë (Leje Pune) për transport publik të udhëtarëve:
Leja e punës për autobus mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:

- a) Aplikacioni,
- b) Të ketë në pronësi së paku një (1) autobus për linjë,
- c) Për çdo linjë, të ketë të punësuar së paku një shofer profesionist të kategorisë "D", me kontratë pune,
- d) Një mekanik për mirëmbajtje, respektivisht kontratën me servisin për mirëmbajtje të autobusëve,
- e) Biznesin e regjistruar në MTI,
- f) Të ketë në pronësi automjetin në emër të biznesit,
- g) Selinë e kompanisë në territorin e komunës sonë,
- h) Të mos ketë ndalesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë.
- i) Certifikata e mjekut, për shoferë të autobusëve,
- j) Patentë shoferi për kategori "D" (kopje), (të ketë më tepër se dy vite përvojë),
- k) Librezat e qarkullimit për autobusët (kopje),
- l) Rendi i Udhëtimit (orari i nisjes - kthimit), të vërtetuara nga drejtoria,
- m) Kontratën për peronimin e autobusëve për nisje dhe kthim,
- n) Pagesa për vërtetim e rendit të udhëtimit 25 €.

2.1 Një(1) minibus - në terrene ku nuk mund të operojnë autobusët, për shkak të konfiguracionit të terrenit.

3. Leja e punës për operator me kombi bus me 8+1 ulëse do të jepet në linjën në të cilën nuk mund të operoj autobusi dhe minibusi dhe aplikuesi duhet të plotëson këto kritere:

- a) Aplikacioni,
- b) Patentë shoferi (kopje)
- c) Të ketë në pronësi së paku një (1) kombi bus për linjë me 8+1 ulëse,
- d) Të jetë banor i komunës së Kaçanikut,
- e) Të posedoj patent shoferin më të vjetër se 5 vite,
- f) Të posedoj certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- g) Të ketë në pronësi automjetin në emër të biznesit,
- h) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- i) Për çdo linjë, të ketë të punësuar së paku një shofer, me kontratë pune,
- j) Kontratën për peronim për nisje dhe kthim,
- k) Certifikata e mjekut, për shofer,
- l) Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,
- m) Pagesa për vërtetimin e rendit të udhëtimit minibus 25 €.
- n) Pagesa për vërtetimin e rendit të udhëtimit për kombi bus 15 €.
- o) Dy fotografi.

4. Leja e punës për taksi veturë (4+1) mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:

- a) Aplikacioni,
- b) Letërnjoftimi (kopje),
- c) Libreza e qarkullimit (kopje),
- d) Të posedoj patent shoferin më të vjetër se pesë (05) vite të kategorisë "B",

- e) Te jete pronar i automjetit me te cilin ushtron kete veprimtari si dhe libreza te jete ne emer te biznesit,
- f) Automjeti të ketë të vendosur firmën "TAXI" në pjesën e përparme të kulmit të automjetit, e cila duhet të ndriçoj natën,
- g) Te mos jet shqiptuar masa mbrojtese e ndalimit te kryerjes se transportit taksi te udhëtareve, me gjatë se gjashtë (6) muaj,
- h) Automjeti të ketë pesë (05) dyer, dhe 4+1 ulëse,
- i) Automjeti të ketë taksimetër (çmimore për km),
- j) Të posedoj certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- k) Të posedoj patent shoferin më të vjetër se pesë (05) vite të kategorisë "B",
- l) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- m) Çertifikata e mjekut,
- n) Pagese për licence/leje auto-taksi 10.00€.
- o) Dy fotografi.

5. Leja e punës për Kompani Taksi – Operator Taksi, mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:

- a) Aplikacioni,
- b) Të ketë selinë në teritorin e komunës së Kaçanikut,
- c) Të ketë certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- d) Të ketë së paku dy (02) automjete në pronësi,
- e) Automjeti të ketë pesë (05) dyer, dhe 4+1 ulëse,
- f) Automjetet të kenë taksimetër (çmimore për km)
- g) Të gjithë shoferët e punësuar, duhet të kenë kontratë pune dhe të posedojnë patent shoferin më të vjetër se pesë (05) vite,
- h) Të mos ketë ndalesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- i) Të ketë vendparkim, frekuenca, zyrë, lidhje telefonike dhe kontratën apo servisën për mirëmbajtje të automjeteve,
- j) Çertifikata e mjekut, për shoferët e punësuar në kompani Taksi,
- k) Licencë-Leje për operator taksi,
- l) Dy fotografi.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve do të jetë 15 ditë, nga dita e publikimit.

Në mungesë të dokumenteve të kërkuara, kërkesa do të refuzohet.
Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në Zyrën e Pranimit, nr. 8/ kati i I-rë.
Për më shumë informacione dhe për marrjen e aplikacionit, mund t'i drejtoheni Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencës.

Vërejtje: Të gjithë operatorët në vija të rregullta të Transportit Publik të Udhëtarëve, me: Autobus dhe Kombi - bus, krahas dokumentacionit të lartshënuar, duhet të paraqesin edhe çmimet e mujoreve dhe biletave, sipas Rendit të Udhëtimit, pasi që çmimorja e paraqitur do të vërtetohet edhe nga drejtoria përkatëse.

